



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

URDHËR

Nr. 42, Datë 27/03/2015


**Mbi miratimin e programit të transparencës për informacionin publik nga
Universiteti i Arteve**

Në zbatim të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", nenit 39, të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të transparencës për informacionin publik në Universitetin e Arteve;
2. Funksionarët e të gjithë niveleve në UART, në funksion të transparencës së veprimitarisë së UART, të njojin mirë kërkesat e ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012, " Për mbrojtjen e të dhënave personale";
3. DMBNJ, është njësia përgjegjëse për regjistrimin e kërkesave, koordinimit dhe përgatitjes së praktikës së informacionit, që do t'i jepet çdo aplikanti që kërkon informacion për dokumentet e prodhuar ose mbahen në UART.
4. Sektori IT, të riformatojë në vazhdimësi faqen e internetit të UART, sipas kërkesave të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit";
5. Të gjithë funksionarët ose përgjegjësit e njësive të veçantë dhe çdo punonjës në UART, janë të detyruar të bashkëpunojnë me DMBNJ, në përgatitjen dhe përgjigjen në kohë, të kërkesave për informim e publiku.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Z/rektorët e UART, Dekanët e Fakulteteve, Kancelari i UART, Drejtoritë pranë rektoratit, dhe të gjitha njësítë sipas strukturës mësimore dhe administrative në Universitetin e Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

URDHËR

Nr. 42, Datë 27/03/2015


**Mbi miratimin e programit të transparencës për informacionin publik nga
Universiteti i Arteve**

Në zbatim të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", nenit 39, të Statutit të Universitetit të Arteve,

URDHËROJ:

1. Miratimin e programit të transparencës për informacionin publik në Universitetin e Arteve;
2. Funksionarët e të gjithë niveleve në UART, në funksion të transparencës së veprimitarisë së UART, të njojin mirë kërkesat e ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" dhe ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012, " Për mbrojtjen e të dhënave personale";
3. DMBNJ, është njësia përgjegjëse për regjistrimin e kërkesave, koordinimit dhe përgatitjes së praktikës së informacionit, që do t'i jepet çdo aplikanti që kërkon informacion për dokumentet e prodhuar ose mbahen në UART.
4. Sektori IT, të riformatojë në vazhdimësi faqen e internetit të UART, sipas kërkesave të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit";
5. Të gjithë funksionarët ose përgjegjësit e njësive të veçantë dhe çdo punonjës në UART, janë të detyruar të bashkëpunojnë me DMBNJ, në përgatitjen dhe përgjigjen në kohë, të kërkesave për informim e publiku.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Z/rektorët e UART, Dekanët e Fakulteteve, Kancelari i UART, Drejtoritë pranë rektoratit, dhe të gjitha njësítë sipas strukturës mësimore dhe administrative në Universitetin e Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





Programi i
transparencës për informacionin publik nga
Universiteti i Arteve

Universiteti i Arteve, është "Autoritet publik", i krijuar në bazë të VKM nr. 234, datë 23.11.2011. Universiteti i Arteve ka përmision:

- "a) ofrimin e studimeve universitare të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fushën e artit e të kulturës;
- b) zhvillimin e mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimit artistik që kryhet brenda e jashtë vendit;
- c) formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e të kulturës;
- ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës;
- d) kryerjen e kërkimeve shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;
- dh) ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë".

Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter artistik në Shqipëri, që ofron Diplomë Universitare Bachelor, Master në Arte, në Muzikë, Arte të Bukura dhe Artet Skenike, etj.

I themeluar më 1966 si Institut i Lartë i Arteve i cili bashkoi tre institucionet artistike: Konservatorin Shtetëror të Tiranës, Shkollën e Arteve të Bukura dhe Shkollën e Lartë të Aktorëve "Aleksandër Moisiu", më 1990, me ndryshimet në sistemin arsimor, Institut i Lartë i Arteve u ngrit në nivel Universiteti duke u bërë kështu institucioni unik në vend për përgatitjen e talenteve të reja në të gjitha fushat e artit dhe që ka marrë përsipër të sjellë prurjet më të mira, më kompetitive e më origjinale për institucionet artistike të vendit si dhe për jetën shoqërore e artistike dhe produktin shpirtëtor shqiptar në të gjitha trevat shqipfolëse.

E gjithë rruga mbi 45 vjeçare e Universitetit të Arteve ka qënë një rrugë e shtimit sistematik të specialitetave dhe vitet e fundit në implementimin e Kartës së Bolonjës.

Aktualisht në auditorët e UAR studiojnë 1100 studentë, të cilët udhëhiqen nga një staf pedagogjik prej 419, pedagoge, profesorë të asociuar dhe profesorë.

Struktura e Universitetit të Arteve përfshin njësitë kryesore si: "Fakulteti i Muzikës, me departamentet përkatës, Fakultetin e Artit Skenik, me departamentet përkatëse, dhe Fakultetin e Arteve të Bukura, me departamentet përkatëse".

Organet drejtuese të Universitetit të Arteve janë: senati akademik, këshilli i administrimit, rektorati.

Autoritetet drejtuese të Universitetit të Arteve janë: rektori, dekanët e fakulteteve dhe Kancelari.

Për një trasparencë sa më të lartë në kryerjen e detyrës, çdo funksionar dhe punonjës në UART duhet të qartësohet se:

1. "Autoritet publik": a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilat i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjeter, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

2. "Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

3. "Person" është çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, si dhe personat pa shtetësi.

4. "Të dhëna personale" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin përmes mbrojtjen e të dhënavë personale, të ndryshuar.

5. "Programe transparence" është tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërges publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neñeve 4 dhe 7 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit".

6. "Koordinator" përmes drejtës informimit përmes transparencës në UART, është DMBNJ.

Programi përmes trasparencës synon rregullimin përmes drejtës informacionin që prodhohet ose mbahet nga organet drejtuese ose autoritete drejtuese të UART, me qëllimin garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve përmes gjendjen e Universitetit të Arteve.

Ky program ka përmes qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së organeve drejtuese dhe autoriteteve drejtuese të Universitetit të Arteve.

Universiteti i Arteve në përgatitjen e këtij program ka parasysh interesin më të mire të publikut dhe sidomos:

- garantimin e njohjes maksimale me informacionin të publikut;
- vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacione, në mënyrë që të pakësohet nevoja përmes kërkuesit individual përmes informacionit nga publiku.

Ky program, *si program i pare i trasparencës*, në zbatim të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", në vazhdëmësi do të rishikohet, minimalisht çdo 5 muaj, në mënyrë që transparensa e informimit përmes dokumentat që prodhohen ose mbahen në Universitetin e Arteve, t'i përgjigjet maksimalisht interesave të publiku.

Programi i trasparencës i UART, do të përshtatet edhe me programet model të "Komisionerit përmes Drejtës Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale".



Në programet e trasparencës, që do të riformatohen në vazhdëmisi, UART do të bëjë kujdes që dokumentat që prodhon ose mban, të jenë sa më të kuptueshme dhe të aksesueshme për publikun, duke i vënë në *dispozicion të publikut në faqen e internet-të* *UART*, kategoritë e detyrueshmë të informacionit.

Universiteti i Arteve, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr.119/2014, " Për të drejtën e informimit", do të rikrijojë "*Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të publikut*", në të cilin do të pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër do të përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të *UART*.

DMBNJ, kërkesat për informim, për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve i plotëson jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës.

Disa nga kompetencat e DMBNJ, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", janë si më poshtë:

- i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njojur me informacionin publik, sipas ligjit nr. 119/2014, " Për të drejtën e informimit", duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;
- krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda 3 muajv;
- *bashkërendon punën me njësitë e tjera të *UART*, për plotësimin e kërkesave për informacione brenda 10 ditëve*;
- regjiston kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
- verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, studentëve, etj. dhe në raste kur informacioni mund të bëhet kundrejtë një tarife, të përcaktuar më parë nga Këshilli i Administrimit të *UART*;
- kryen njoftimet paraprake, për mënyran e dhënjes së informacionit sipas neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 119/2014, " Për të drejtën e informimit";

Organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të *UART*, në çdo moment, në çdo informim të studentëve, punonjësve, qytetarëve, etj, janë të detyruar të kenë parasysh kufizimin në raste të domosdoshme, proporcional dhe nëse dhënia e informacionit démon tonë drejtën për një jetë private. Në këtë drejtim, mbahen parasysh kërkesat e ligjit nr.9887, date 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012, "Për mbrojtjen e të dhënëve personale".

Në raste mosrespektimi të dispozitave të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

- a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- b) mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
- c) mosrishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
- ç) mosndjekja e procedurave për rishikimin e programit institucional të transparencës, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;

Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tirana Shqipëri, Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

- d) moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrat të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
- dh) mosplotësimi i kërkesave për informacione, të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit dhe sipas mënyrës së parashikuar në nenin 9, të këtij ligji dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- e) mosregjistrimi i kërkesës për informim, moscaktimi i një numri rendor për të dhe mosdhënia e të dhënavë të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- ë) mosdërgimi i kërkesës për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- f) dërgimi i kërkesës për informim tek një autoritet tjetër publik kur autoriteti që ka marrë kërkesën e ka informacionin e kërkuar, në kundërshtim me kërkesën e pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- g) mosnjoftimi i kërkuesit se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër dhe kontaktet e nevojshme i janë dërguar autoritetit tjetër, në kundërshtim me parashikimet e pikës 3, të nenit 12, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
- gj) mospërcaktimi paraprakisht i një tarife, mospublikimi, ose caktimi i tarifave abuzive për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- h) mosrespektimi i kërkesave të pikës 4, të nenit 13, të këtij ligji, për dhënien falas të informacionit, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë;
- i) refuzimi i paarsyetuar i preferencës së kërkuesit për mënyrën e dhënieve së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e pikës 4, të nenit 14, të këtij ligji dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;
- j) mosnjoftimi i kërkuesit përvendimin përzgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesës për informim, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 15, të këtij ligji dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- k) moskryerja e njoftimeve paraprake, sipas parashikimeve të nenit 16, të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", dënohet me 25 000 deri në 50 000 lekë;
- l) dëmtimi ose shkatërrimi i dokumenteve zyrtare, me qëllim shhangjen e së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë;
- ll) moszbardhja e dokumenteve zyrtare, në kundërshtim me rregullat në fuqi, me qëllim pengimin e ushtrimit të së drejtës për informim, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.

Procedurat e konstatimit, shqyrimit, ankimit dhe ekzekutimit të kundërvajtjeve administrative janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Bashkelidhur:

1. lidhja nr. 1, Programi i transparencës për Universitetin e Arteve;
2. lidhja nr. 2, Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
3. lidhja nr. 3, Përgjigja;
4. lidhje nr.4/a, Mbi refuzimin e forms së kërkuar të informacionit/ dokumentacionit;
5. lidhja nr.4/b, Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes;
6. lidhja nr.4/c, njoftimi përfillimin e procedures për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit.

LIDHJA NR. 1

PROGRAMI I TRANSPARENÇËS PËR Universitetin e Arteve

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Universitetin e Arteve. Ky program përcakton një kornizë paraprake ligjore të veprimtarisë së UART në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Universiteti i Arteve ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. UART do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik sipas këtij programi, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së UART, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www uart.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut ose mjedise të tjera.

Në përbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përbajtje. Faqja zyrtare e UART është ndërtuar dhe do të riformatohet në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësish të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare të UART pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënavë personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënavë, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së UART janë:

1. "E drejta për informim" është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënavë: UART ushtron funksione publike, përrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e UART dhe përkatësisht: Ligji nr. 9832 datë 21.05.2007, " Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënavë Personale" (këtej e tutje KDIMDP).

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë do të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësishët i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinalë në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me këtë program transparency të miratuar me Urdhër nr._____, date ____/____/2015, UART ka vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www uart.edu.al dhe në mjetet e pritjes së publikut ose mjetet e tjera, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave kryesore të organeve dhe autoriteteve drejtuese në UART;
- përditësimi të dokumentave bazë ligjor mbi të cilin mbështet funksionimin e UART;
- përditësimi të ligjit të nr. 9832, date 12.11.2007, Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, vendimi nr.9, date 19.03. 2008, të Gjykatës Kushtetuese, VKM, Udhëzime dhe Urdhëra të MAS, Kontrata Individuale e Studimit (*tip- për studentët*), etj., akte ligjore të zbatueshme në UART;
- Vendimet e Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit, Urdhërat e Rektorit, Urdhërat e Dekanëve, etj. dokumenta përgjigjësuese;
- informacion për procedurat që duhet ndjekur nga publiku, për të mare një informacion pranë DMBNJ të UART;
- të dhënë për orarin e pritjeve të publikut nga autoritetet drejtuese të UART;
- të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të UART, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, " Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë";
- strukturat e pagave për nëpunësit dhe punëtorët në UART;
- kompetencat dhe detyrat e organeve dhe autoriteteve drejtuese, dhe procedurat për marrjen e vendimeve, nxjerjen e urdhërave, etj.

- tē dhëna pēr buxhetin dhe planin e shpenzimeve pēr vitin financier nē vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor pēr zbatimin e buxhetit;
- informacion pēr procedurat e prokurimit sipas parashikimeve tē ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Pēr prokurimin publik", i ndryshuar,
- listën e kontratave tē lidhura, ndër vite me operatorët ekonomik;
- përshkrim tē thjeshtë tē sistemit që përdor UART pēr mbajtjen e dokumentacionit, tē llojeve, formave tē dokumentave, si dhe tē kategorive tē informacionit që bëhet publik pa kérkesë;
- Një informacion pēr dhënien e bursave pēr studentët, pērjashtimin ose reduktimin e tarifave tē shkollimit pēr studentët, etj;
- tē akteve që përbajnjë rregulla, norma apo kufizime tē tē drejtave dhe lirive themelore tē individit;
- afishimi brenda 48 orë prej miratimit, tē çdo vendimi, urdhëri, udhëzimi, dokument, i UART, me efekt tē drejtëpërdrejt pēr publikun, studentët, punonjësit, etj.;
-etj.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë që ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇËS SË UART

Kategoritë e informacionit publik pa kérkesë	Baza ligjore	Dokument i/Përbajtja	Afati kohor pēr publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave tē autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	<i>p.sh:</i> <i>Struktura organizative vendoset e plotë ose në link.</i>	<i>p.sh:</i> <i>1) Menjëherë pas miratimit nga KA, etj.</i>	<i>p.sh:</i> <i>Referohet menuja përkatëse nē faqe zyrtare.</i>	<i>p.sh: DMBNJ; Titullari ose nëpunësi i deleguar prej tij.</i>
Akte ndërkontaktore ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b				

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkësë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim e kërkësave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g				
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Rekotoratit, Fakultete, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ ç				
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d				
Mekanizmat monitorues; raporte auditivi; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/ dh				
Buxheti	Neni 7/1/e				
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë				
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f				
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj				

Mbajtja e dokumentacionit nga UART	Neni 7/1/h				
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i				
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k				
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l				

Çdo njësi në UART, të ketë të plotësuar tabelën e mësipërme të përditësuar me dokumentat që prodhon ose mban dhe DMBNJ, nëpërmjet njësisë të IT, i pasqyron në faqen e internetit www uart.edu.al

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Universiteti i Arteve vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www uart.edu.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, ose mjedise të tjera, kategoritë e dokumentave sipas tabelës së mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar "Programi i Transparencës".

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në çdo moment mund të bëjë rekomandime për organet dhe autoritetet drejtuese të UART, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programit të transparencies .

LIDHJA NR. 2**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

Nr. Rendor (1)	Data e rregjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1		(Përmban edhe përbledhje të kërkesës)	(Përmban edhe përbledhje të përgjigjes)		
2					
3					

Shënim:

Rregjistri përditësohet çdo tre muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nepermjet klikimit njohja me përbledhjen e përgjigjes.

*(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008
“Për mbrojtjen e të dhënave personale”)*

- (5) Ndihmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uarl.edu.al

LIDHJA NR. 3 (përgjigja)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/201___

Lënda: Jepet informacioni/dokumentacioni i kërkuar.

Kërquesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në cilësinë e kërquesit keni depozituar pranë (autoriteti publik), në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor ___, datë ___/___/201_ (sipas rregjistrat përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni (përshkrim i akteve/informacioneve /dokumentacionit që kërkohet).

1. _____
2. _____
3. _____

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uar.edu.al

LIDHJA NR. 4/a

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/201___

Lënda: Mbi refuzimin e formës së kërkuar të informacionit/dokumentacionit.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsy se (arsyetohet pse autoriteti nuk disponon..(p.sh) të tillë mjete/ aparate/ pajisje që bëjnë të mundur dhënien e dokumentacionit në formatin e kërkuar), ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar.

Ndaj refuzimit të kérkesës tuaj, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënavë personale, në përputhje me nenin 24/1,2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

LIDHJA NR. 4/b

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/201___

Lënda: Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes.

Kërkesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim tëpikës 3 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", për arsy se (evidentoni në përputhje me parashikimet në gërmat "a", "b", "c" të nenit 15/3), vendoset për zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes me 5 ditë pune.

Ndaj mosnjoftimit të zgjates së afatit të shqyrtimit, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënavë personale, në përputhje me nenin 24/1/2/a të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Prof. Petrit MALAJ

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**

Shënim:

Ky akt zyrtar i njoftohet menjëherë kërkuesit.



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488. www.uart.edu.al

LIDHJA NR. 4/c

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ___/___/201___

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju njoftojmë se ka nisur procedura për rishikimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", në përputhje me ligjin nr.8457, datë 11/02/1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", i ndryshuar.

Në këtë rast, afati për vlerësimin e dhënies së informacionit shtyhet (deri në 30 ditë pune).

Prof. Petrit MALAJ

**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**